



YOUTH INITIATIVE FOR HUMAN RIGHTS
NISMA E TË RINJVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT
INICIJATIVA MLADIH ZA LJUDSKA PRAVA

Statuti i Organizatës

Ky statut rregullon shoqatën jofitimprurëse "Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë; Youth Initiative for Human Rights - Kosovo; Inicijativa mladih za ljudska prava - Kosovo", e themeluar në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Neni 1

Emri, lloji dhe adresa

1. Organizata do të quhet Nisma e të Rinjëve për të drejtat e njeriut - Kosovë, Youth Initiative for Human Rights - Kosovo, Inicijativa mladih za ljudska prava - Kosovo.
2. Mund të njihet poashtu si YIHR KS.
3. Organizata është një shoqatë jo-fitimprurëse, sipas përkufizimit të dhënë nga neni 16 pika 1 të ligjit nr, 06/L-043, për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës.
4. Organizata nuk do të shpërndajë asnjë përfitim neto, ose perfitime të tilla për cilindo person. Asetet, të ardhurat, dhe përfitimet e organizatës do të përdoren për të mbështetur qëllimet e saja jofitimprurëse dhe nuk do të përdoren për të siguruar përfitime të veçanta individuale, direkt ose indirekt, për asnjë themelues, drejtor, zyrtar, anëtar të shoqatës, punonjës ose donator të YIHR KS. Sidoqoftë, pagesa e kompensimit të arsyeshëm ndaj personave të tillë mund të bëhet për punën e kryer për organizatën.
5. Çdo transaksion ndërmjet YIHR KS dhe çdo organizate tjetër të lidhur, ose midis YIHR KS ose anëtarëve, zyrtarëve, anëtarëve të Bordit ose punonjësve të saj, është i ndaluar, përveç nëse organi drejtues vendosë, pas një hetimi të arsyeshëm, se transaksioni është në interes, i drejtë dhe i arsyeshëm për YIHR KS, dhe që YIHR KS nuk mund të ofroj marrveshje më të favorshme një rregullim më të favorshëm me përpjekje të arsyeshme nën rrethanat ekzistuese.
6. YIHR KS mund të angazhohet në aktivitete ekonomike, me qëllim që të mbështes aktivitete jofitimprurëse, në përputhshmëri me paragrafin 1.4 të Statutit dhe nenin 35.2 të Ligjit për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, me kusht që të ardhurat e krijuara përmes veprimtarive ekonomike të përdoren ekskluzivisht për të përmbushur qëllimet e specifikuar në këtë statut.

7. YIHR KS ka selinë e saj në **Rr. Adrian Krasniqi, 5, kati 2, Prishtinë, 10,000 Kosovë.**

8. YIHR KS do të jetë një trashëgimtare ligjore dhe misionare e organizatës joqeveritare "Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut; Youth Initiative for Human Rights; Inicijativa mladih za ljudska prava", e regjistruar në Ministrinë për Shërbime Publike të Qeverisë së Kosovës më 24 nëntor 2004 (numri i regjistrimit 5300445-8).

Neni 2

Themeluesit

1. Themeluesit e organizatës janë:

- **Shpend Qamili**
- **Raba Gjoshi**
- **Besart Lumi**

2. Asambleja e Anëtarëve cakton Përfaqësuesin e Autorizuar të YIHR KS, i cili përfaqëson organizatën dhe merr të gjitha njoftimet zyrtare në emër të organizatës. Ai ose ajo do të jetë përgjegjës për informimin e autoriteteve përkatëse kompetente për çdo ndryshim në të dhënat e deklaruar gjatë regjistrimit të organizatës.

3. Përfaqësuesi i Autorizuar i YIHR KS është Drejtori Ekzekutiv.

Neni 3

Qëllimet

1. Qëllimi i Organizatës është të promovoj, mbrojë dhe avokoj për të drejtat e njeriut, ballafaqimin me të kaluarën, sundimin e ligjit dhe vlerat qytetare si themelet kryesore të një shoqërie të lirë, të përgjegjshme dhe përparimtare.

2. Organiza është themeluar me qëllim të:

- a) Sigurimit të respektimit të të drejtave të njeriut, vlerave demokratike dhe sundimit të ligjit;
- b) Fuqizimit të të rinjët dhe aktivizmit për të drejtat e njerit;
- c) Krijimit të platformave për ballafaqimin me të kaluarën dhe ndërtimin e paqes në Kosovë, si dhe në rajon.

3. Për të realizuar qëllimet e saja, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet në këto aktivitete: fushata të avokimit, dokumente të politikave, programe të monitorimit, grante të vogla, shkëmbime të të rinjve, trajnime, punëtori, debate publike, hulumtim dhe dokumentacion, aksione në rrugë dhe aktivitete të tjera në përputhje me misionin dhe objektivat e organizatës.

Neni 4

Anëtarësimi

1. Anëtarësimi në organizatë është i hapur për çdo person pavarshisht, rascës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike apo të tjera, origjinës kombëtare apo shoqërore, ndërlidhje me çdo komunitet, pronë, kushte ekonomike dhe sociale, orientim seksual, lindje, paaftësi ose ndonjë status tjetër personal. Për t'u anëtarësuar në organizatë, çdo person i interesuar do të pranoj Statutin dhe Misionin e organizatës dhe do të angazhohet në përmbushjen e qëllimeve të organizatës.
2. Asambleja e Anëtarëve përcakton nëse kërkohet një tarifë anëtarësie nga anëtarët. Në rast të detyrimit për pagesë të anëtarësisë, Kuvendi vendosë për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësisë, përfshirë masa të ndryshme, deri në përjashtimin e anëtarit nga organizata në rast të mos pagimit të anëtarësisë.
3. Anëtarësimi i cilitdo anëtarë mund të ndërpritet ose pezullohet me vendim të Asamblesë së Anëtarëve në rast të:
 - a) Mos respektimi i Statutit të YIHR KS,
 - b) Mos përmbushja e veprimve në interes dhe në imazh të YIHR KS,
 - c) Mungesa e njëpasnjëshme në tre MPV konsektive.
4. Në rast pezullimi, kohëzgjatja e pezullimit do të përcaktohet nga Asambleja e Anëtarëve.
5. Përfundimi ose pezullimi i anëtarësisë nga Asambleja e Anëtarëve vendoset nga shumica e anëtarëve të pranishëm.

Neni 5

Asambleja e Antarëve

1. Asambleja e Anëtarëve është organi më i lartë drejtues i organizatës dhe përbëhet nga të gjithë anëtarët e organizatës.
 2. Asambleja e Anëtarëve do të ketë përgjegjësi përfundimtare për politikën dhe çështjet financiare të organizatës. Në këtë kontekst, Asambleja e Anëtarëve ka fuqinë të:
 - a) Zgjedhë dhe shkarkoj Drejtorin Ekzekutiv bazuar në propozimin e Bordit,
 - b) Miratoj raportin vjetor të punës dhe raportin financiar bazuar në propozimin e Bordit,
 - c) Miratoj amandamente dhe ndryshime në Statut,
 - d) Vendosë për bashkimin, ndarjen ose shpërbërjen e YIHR KS.
- Këto përgjegjësi nuk mund të delegohen tek organet e tjera më të ulëta.
3. Përveç kompetencave të rezervuara, Asambleja e Shoqatës ka gjithashtu këto kompetenca:
 - a) Përcakton misionin dhe objektivat e YIHR KS,
 - b) Zgjedhë dhe shkarkon anëtarët e Bordit,
 - c) Pranon dorëheqjen e anëtarëve të Bordit nga një shumicë e anëtarëve të pranishëm,

- d) Miraton vendime për ndryshimin e objektivave të YIHR KS dhe shpërbërjen e saj, me shumicë absolute të dy të tretave,
- e) Miraton vendimin për shpërndarjen e pasurive të mbetura të YIHR KS, me shumicë absolute të dy të tretave.

4. Asambleja e Anëtarëve mund të delegoj ndonjë nga përgjegjësitë e saj tek Bordi dhe Drejtori Ekzekutiv, me vendimin e shumicës së anëtarëve të saj, me përjashtim të përgjegjësive që nuk janë deleguar në bazë të nenit 31.5 të Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare në Republikën e Kosovës dhe paragrafi 2 i nenit 5 të Statutit.

5. Bordi zgjedh sekretarin e organizatës në bazë të një propozimi të paraqitur nga Kryetari i Bordit. Sekretari emërohet për një mandat dy vjeçar. Sekretari ka këto detyra:

- a) Të mbajë procesverbal gjatë mbledhjeve të Asamblesë,
- b) Të përgatisë dokumentacionin për mbledhjet e Asamblesë dhe Bordit,
- c) Kujdeset për organizimin teknik të mbledhjeve të Asamblesë dhe Bordit,
- d) Siguron mirëmbajtjen e "Listës së Anëtarëve".

6. Nëse Sekretari për çfarëdo arsye jep dorëheqje, ai automatikisht përfundon mandatin e tij/saj si sekretar. Në këtë rast Bordi, me propozimin e Kryetarit, është i detyruar të zëvendësojë Sekretarin brenda 30 ditëve.

Neni 6

Takimet e Asamblesë së Antarëve

1. Asambleja e Anëtarëve duhet të mblidhet të paktën çdo vit në një Mbledhje të Përgjithshme Vjetore (MPV) ku duhet të rishikoj dhe aprovoj raportin për fondet, detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar, si dhe planin për fondet e parashikuara dhe detyrimet, të ardhurat, shpenzimet dhe programet për vitin e ardhshëm.

2. Asambleja e Anëtarëve gjithashtu mund të mblidhet në Takime të Përgjithshme të Jashtëzakonshme (TPJ) kurdo që kërkohet nga 1/3 e anëtarëve. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Sekretarit të Asamblesë i cili do t'ua lëshoj njoftimin e mbledhjes të gjithë anëtarëve, sipas procedurës së përshkruar në paragrafin vijues.

3. Njoftimi me shkrim i MPV-ve dhe/ose TPJ-ve, që tregojnë datën dhe vendin e mbledhjes, së bashku me agjendën e mbledhjes, do t'u shpërndahet të gjithë anëtarëve të paktën shtatë ditë para ditës në të cilën do të mbahet mbledhja.

4. Në mënyrë që mbledhja të zhvillohet, kërkohet pjesëmarrja e më shumë se gjysmës së anëtarëve. Nëse kuorumi nuk është arritur në përpjekjen e parë, mbledhja do të shtyhet për një datë të caktuar të mëvonshme dhe një njoftim i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.

5. Secili antarë i Organizatës e ka një votë në Asamblesë e Anëtarëve.

6. Vendimet në Asamblenë e Anëtarëve merren me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
7. Asnjë anëtarë i Asamblesë së Anëtarëve nuk lejohet të marrë pjesë në diskutim ose ndërmarrje të vendimit për ndonjë çështje në të cilën ai ka një interes ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Anëtarë i Asamblesë së Anëtarëve konsiderohet se ka interes ekonomik, nëse ai ose ndonjë anëtarë i familjes së tij ka një interes ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.
8. Mbledhjet kryesohen nga Kryetari i Asamblesë i cili zgjidhet në fillim të çdo mbledhje me një propozim të Kryetarit të Bordit.
9. Personat e caktuar si "Miq të YIHR KS", të cilët nuk janë anëtarë mund të ftohen të vëzhgojnë mbledhjet. Ata nuk llogariten në kuorum dhe nuk kanë të drejtë vote.

Neni 7

Organi Drejtues i Ndërmjetëm (Bordi)

1. Bazuar në përgjëgjësitë e dhëna nga ky statut, Organi Drejtues i Ndërmjetëm, gjithmonë duhet të veproj në përputhshmëri me qëllimet e organizatës.
2. Bordi do të ketë këto përgjegjësi:
 - a) Propozon amandamentime dhe modifikime të Statutit dhe akteve tjera në përgjithësi të organizatës për aprovimin nga Asambleja.
 - b) Zgjedhë Kryetarin e Bordit nga radhët e tij,
 - c) I propozon Asamblesë drejtorin Ekzekutiv,
 - d) Miraton procedurën për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv,
 - e) Mbikëqyr punën e Drejtorit Ekzekutiv,
 - f) Miraton rregullat e procedurave dhe politikat e tjera organizative,
 - g) Miraton politikat e reja të propozuara nga Drejtori Ekzekutiv,
 - h) Shqyrton raportin vjetor të punës dhe raportin financiar të përgatitur nga Drejtori Ekzekutiv dhe i propozon Kuvendit për miratim,
 - i) Zgjedhë dhe shkarkon nga detyra sekretarin e organizatës
 - j) Në bazë të një propozimi të paraqitur nga çdo anëtar i Bordit, mund të jap çertifikata të veçanta të meritës për individët që kanë kontribuar shumë në punën dhe zhvillimin e YIHR KS.
3. Bordi duhet të propozohet dhe të përzgjidhet nga Asambleja. Ata do të përzgjidhen në mënyrë individuale nga shumica e votave të anëtarëve që janë prezent.
4. Bordi përbëhet nga së paku 3 (tre) anëtarë: njëri prej tyre zgjidhet Kryetar i Bordit.
5. Bordi duhet të mbledhet së paku një herë në vit,
6. Mbledhjet e Bordit thirren dhe drejtohen nga Kryetari i Bordit.
7. Seancat e Bordit Drejtues do të ndjeken nga Drejtori Ekzekutiv.

8. Anëtarët e Bordit mund të zgjidhen për një mandat të rradhës, ata do të kenë një mandat dy-vjeçar.
9. Antarët e Bordit mund të përjashtohen përpara përfundimit të mandatit nga shumica e votave të Asambles së Anëtarëve.
10. Mandati i anëtarit të Bordit pushon në rast të:
 - a) Vdekjes,
 - b) Dorëheqjes, ose
 - c) Shkarkimit nga Asambleja e Anëtarëve.
11. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të një anëtari të Bordit, Asambleja e Shoqatës zgjedhë një pasardhës për të shërbyer për kohën e mbetur, jo më vonë se 90 ditë nga data e përfundimit të anëtarësisë.
12. Nëse anëtarësimi i Bordit ndërpritet për jo më pak se tre anëtarë të Bordit njëkohësisht ose brenda një periudhe kohore të shkurtër, nga Asambleja kërkohet që të zgjedhë anëtarë të rinj brenda 15 ditëve.
13. Dorëheqja nga anëtarësia i paraqitet Kryetarit të Bordit me shkrim.
14. Vendimet e Bordit merren nga shumica e anëtarëve të pranishëm.
15. Bordi mund të vendosë t'i referojë çdo çështje Asambles së Anëtarëve për vendim.
16. Asnjë shpërblim ose kompensim nuk do t'i paguhet anëtarëve të Bordit pa miratimin e Asamblesë së Anëtarëve dhe vetëm kur pagesa ose kompensimi është i arsyeshëm dhe për punën e kryer për organizatën.
17. Asnjë anëtar i Bordit nuk lejohet të marrë pjesë në diskutime ose të marrë vendime për ndonjë çështje në të cilën ai ka një interes ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë. Një anëtar i Bordit konsiderohet se ka interes ekonomik nëse ai/ajo ose ndonjë anëtar i familjes së tij/saj ka një interes ekonomik të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

Neni 8

Drejtori Ekzekutiv

1. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Asambleja e YIHR KS me propozimin e Bordit me 2/3 (dy të tretat) e anëtarëve të pranishëm, me një mandat katër vjeçar. Drejtori Ekzekutiv mund të zgjidhet për mandate radhazi.
2. Drejtori Ekzekutiv duhet të ketë këto përgjegjësi:
 - a) Menaxhimin e plotë të veprimtarisë dhe aktiviteteve të YIHR KS,
 - b) Të sigurojë që vendimet e Bordit të vihen në fuqi,
 - c) Merr vendime të nevojshme për funksionimin e rregullt të organizatës YIHR KS,
 - d) Përfaqëson dhe vepron në emër të organizatës YIHR KS,

- e) Menaxhon pasuritë e YIHR KS në përputhje me ligjin, statutin, planin financiar dhe vendimet e Bordit,
- f) Rekruton stafin dhe bashkëpunëtorët,
- g) Propozon në Bord planin strategjik të organizatës,
- h) Propozon në Bord ndryshime dhe modifikime të rregullave të procedurave dhe politikave të tjera organizative,
- i) Propozon politika të reja,
- j) Dorëzon Bordit planin vjetor,
- k) Mban takime me donatorët dhe angazhohet në aktivitete për mbledhjen e fondeve për organizatën,
- l) Bashkëpunon me organizata dhe institucione të tjera,
- m) Përgatitja e rregullave të procedurave dhe politikave të tjera organizative dhe sigurimi i respektimit të plotë me Rregullat e procedurave dhe politikave,
- n) Kryen të gjitha detyrat e tjera të nevojshme për funksionimin e qetë të YIHR KS.

3. Drejtori Ekzekutiv dhe zyrtarët e tjerë duhet të punësohen sipas Ligjit për Punën në Republikën e Kosovës, të gjitha të ardhurat dhe përfitimet e tjera që duhet t'i paguhen Drejtorit Ekzekutiv dhe zyrtarëve të tjerë, dhe detyrimet dhe përshkrimi i punës dhe përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv dhe zyrtarëve të tjerë. Të gjitha pagesat duhet të jenë të arsyeshme dhe duhet të paguhen vetëm për punën e kryer për organizatën.

Neni 9

Shpërndarja e organizatës

1. Organizata mund të shpërndahet me vendim të shumicës së anëtarëve të Asamblesë së Anëtarëve në rastet e:

- a) Falimentimit,
- b) Devijimit nga misioni dhe objektivat e organizatës,
- c) Përmbushjes së misionit dhe objektivave të organizatës në mënyrë që mos ketë më nevojë që organizata të ekzistojë.

2. Kur vendoset për shpërbërjen e organizatës, Asambleja e Anëtarëve do të tregojë emrin e ndonjë shoqate ose fondacioni në Kosovë që do të marrë asetet e mbetura pas shlyerjes së çdo detyrimi të mbetur nga organizata. Shoqata (t) ose fondacioni (et) e zgjedhur duhet të kenë qëllime të njëjta ose të ngjashme me organizatën.

Neni 10

Ndryshimet në statut

1. Ky statut mund të ndryshohet ose modifikohet me vendimin e 2/3 (dy të tretave) të anëtarëve të pranishëm të Asamblesë së Anëtarëve.

Neni 11

Periudhat e raportimit dhe viti financiar

1. Bordi dhe Zyrtarët e emëruar i japin raportet vjetore Asambles të Anëtarëve gjatë MPV-së çdo here që kërkohet një TPJ.
2. Viti financiar i organizatës përkon me vitin kalendarik.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Ky është një modifikim i statutit të YIHR KS bazuar në nenin 37 të statutit të datës 05.04.2001.
2. Ky Statut hyn në fuqi në datën e miratimit nga Anëtarët e Asambles dhe nënshkruar nga Përfaqësuesi i Autorizuar i YIHR KS dhe shfuqizon Statutin e vjetër të datës 05.04.2011.

Ky statut është dakorduar në ***Prishtinë***,

Më 26.12.2019

Marigona Shabiu

Nga Asambleja e Anëtarëve

Përfaqësues i Autorizuar